



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

Nr. 98/ prot.

Tiranë, më 21.07.2025

VENDIM

Nr. 1197, Datë 21.07.2025

**“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NDAJ
NDËRMARRJEVE AMERICAN HOSPITAL SHA DHE INTERNATIONAL HOSPITAL
SHA NË TREGUN E SHËRBIMIT SPITALOR”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.07.2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për mbylljen e procedurës së hetimit paraparak ndaj ndërmarrjeve American Hospital SHA dhe International Hospital SHA në tregun e shërbimit spitalor.

Baza Ligjore: Neni 24, germa (d), neni 26, neni 43, pika 5 dhe dhe neni 45, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Konkurrencës:

VËREN SE :

1. Në kuadër të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2022”, Autoritetit i është kërkuar të ndërmarrë një procedurë monitorimi apo hetimi në tregun e shërbimit spitalor privat, me qëllim vlerësimin e funksionimit të konkurrencës në këtë treg, sidomos në kushtet e zhvillimeve të fundit të strukturës së pronësisë në këtë sektor.
2. Gjatë fazës së analizës paraprake, u evidentua se ndërmarrjet American Hospital SHA dhe International Hospital SHA (shoqëri tashmë e bashkuar me përdhithje) zotërojnë pjesën më të madhe të të ardhurave të realizuara në këtë treg për periudhën 2022–2023. Duke u bazuar në nenin 8 të Ligjit nr. 9121/2003, kjo situatë ngre dyshime për ekzistencën e pozitës dominuese.
3. Gjithashtu, u morën në shqyrtim disa shërbime të specializuara të cilat ofrohen ekskluzivisht nga këto dy spitale private, përfshirë ndërhyrje të avancuara si trombektomia mekanike, PET-Scan/PET-CT dhe transplantit i veshkave, që përbëjnë potencialisht “shërbime të domosdoshme” në kuptimin e analizës së nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003.

4. Duke marrë në konsideratë përmasën ekonomike të këtyre ndërmarrjeve, portofolin e avancuar të shërbimeve, si dhe rolin e tyre të rëndësishëm në ofrimin e kujdesit terciar, u vendos që të zhvillohej një hetim paraprak për të vlerësuar nëse sjellja e tyre përbën ose jo një abuzim me pozitën dominuese.
5. Për të analizuar në mënyrë të hollësishme tregun dhe sjelljen e ndërmarrjeve objekt hetimi, Autoriteti u fokusua në disa paketa shërbimi për të cilat nuk ekzistojnë alternativa të barasvlershme në tregun shqiptar.
6. Për shkak të veçorisë së këtij tregu, Autoriteti ka marrë në konsideratë edhe elementët e rregullimit sektorial që ndikojnë në treg dhe zhvillimin e konkurrencës, përfshirë: procedurat e licencimit dhe klasifikimit të spitaleve, kriteret për ofrimin e shërbimeve të avancuara dhe rolin e Ministrisë së Shëndetësisë në përcaktimin e standardeve minimale dhe teknologjisë së përdorur.
7. Një tjetër element i rëndësishëm është se, ndryshe nga tregjet e tjerë, në sektorin shëndetësor përparësitë konkurruese lidhen edhe me nivelin e investimeve teknologjike dhe disponueshmërinë e profesionistëve të kualifikuar, të cilat mund të përbëjnë barriera të natyrshme në ofrimin e shërbimeve të avancuara nga aktorë të rinj në treg.
8. Tregu përkatës i produktit për qëllimet e këtij hetimi përcaktohet si tregu i shërbimeve spitalore, duke përfshirë të gjitha shërbimet mjekësore për pacientët të ofruara nga ndërmarrjet American Hospital SHA dhe International Hospital SHA.
9. Duke marrë në konsideratë natyrën e shërbimeve të ofruara nga ndërmarrjet objekt hetimi, të cilat përfshijnë ndërhyrje të avancuara dhe të specializuara, si transplante apo procedura të teknologjisë së lartë dhe faktin që këto shërbime tërheqin pacientë nga i gjithë vendi, tregu përkatës gjeografik përcaktohet si territori i Republikës së Shqipërisë.
10. Pozita dominuese, sipas nenit 3, pika 5 të Ligjit nr. 9121/2003, nënkupton fuqinë ekonomike që i mundëson një ose më shumë ndërmarrjeve të veprojnë në mënyrë të pavarur nga konkurrentët, klientët apo konsumatorët, duke penguar konkurrencën efektive në treg.
11. Praktika e Komisionit Evropian thekson se zotërimi i një pjese të konsiderueshme të tregut për një periudhë të gjatë kohore përbën një tregues të fortë të pozitës dominuese, sidomos në tregje me pengesa të larta hyrjeje dhe me pak aktorë¹.
12. Në mënyrë të veçantë, një ndërmarrje mund të konsiderohet me pozitë dominuese kur është në gjendje të rrisë çmimet përtej niveleve konkurruese ose të ndikojë në cilësinë, shumëllojshmërinë dhe risitë e ofruara në treg, në mënyrë që të përfitojë vetë në dëm të konsumatorëve.
13. Ndërmarrja American Hospital SHA, në sajë të ofrimit të shërbimeve ekskluzive si trombektomia mekanike dhe transplantit i veshkave, ushtron kontroll të plotë mbi segmentin përkatës të tregut, duke zotëruar të pjesën e tregut për ato shërbime.
14. Ndërmarrja International Hospital SHA, në sajë të ofrimit të shërbimeve si PET-scan/PET-CT, transplantit i veshkave dhe paketat e avancuara radiologjike, gjithashtu zotëron të pjesën e tregut për këto shërbime.

¹ Komunikim nga Komisioni Udhëzim mbi sjelljet përjashtuese, lidhur me zbatueshmërinë e nenit 82 -Guidance on the Commission's enforcement priorities in applying Article 82 of the EC Treaty to abusive exclusionary conduct by dominant.

15. American Hospital SHA është një shoqëri aksionare që operon në fushën e shërbimeve shëndetësore jopublike në Shqipëri dhe ofron shërbime përmes disa degëve të shpërndara në qytete të ndryshme të vendit, përkatësisht: Spitali Amerikan 1, 2, 3 në Tiranë, Spitali Amerikan Fier, Durrës, Shkodër dhe Gjirokastrë. Kjo shtrirje gjeografike e bën ndërmarrjen një nga ofruesit më të mëdhenj privatë të shërbimit spitalor në vend dhe ndikon ndjeshëm në perceptimin e konsumatorit për akses dhe kapacitete teknike.
16. Sipas të dhënave të dërguara nga vetë ndërmarrja me shkresën e datës 27.03.2025 dhe të protokolluara pranë Autoritetit të Konkurrencës më datë 28.03.2025, rezulton se ndërmarrja American Hospital SHA ofron dy shërbime spitalore të specializuara dhe të konsideruara ekskluzive në treg: trombektomia mekanike dhe transplantit i veshkave. Nga informacionet e verifikuara në kuadër të hetimit paraprak, këto ndërhyrje nuk realizohen aktualisht në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” apo në ndonjë institucion tjetër publik.
17. Sipas të dhënave të deklaruara dhe të verifikuara, për vitin 2022 ndërmarrja American Hospital SHA zotëronte të tregut, ndërsa për vitin 2023 zotëronte duke ruajtur një pjesëmarrje të lartë në tregun e përgjithshëm të shërbimeve spitalore. Këto tregues përbëjnë elementë objektivë për vlerësimin e një pozite dominuese, në përputhje me praktikën e Komisionit Evropian, sidomos në tregje ku diferencimi i shërbimit dhe barrierat e hyrjes janë të theksuara.
18. Nga analizat rezulton se transplantit i veshkave është pjesë e listës së paketave të financuara nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH), përfshirë edhe rastet kur realizohen në spitale jopublike. Megjithatë, për shkak të mungesës së kapaciteteve në sistemin shëndetësor publik, një pjesë e konsiderueshme e ndërhyrjeve transferohen drejt sektorit privat përmes kontratave me FSDKSH. Ky mekanizëm, ndonëse ofron përfitim publik, krijon një avantazh tregtar për ndërmarrjen që është e vetmja ofruese e këtij shërbimi, duke i siguruar fluks të qëndrueshëm pacientësh dhe të ardhurash të garantuara nga buxheti i shtetit.
19. Transplantit i veshkës (me pagesë) ka gjeneruar të ardhura vjetore prej me një normë fitimi bruto , ndërkohë që transplantit renal i financuar nga FSDKSH ka rezultuar me të ardhura prej , por me normë negative duke sugjeruar se financimi publik mbulon më shumë kostot dhe është ekonomikisht më pak fitimprurës. Duke qënë se transplantit renal përbën një zë të vetëm si shërbim, në total norma e fitimit është në nivele normale që nuk konsiderohen abuzuese. Trombektomia mekanike e cila ka realizuar të ardhura prej në total për 3 vite (2022, 2023, 2024) çka përbën vetëm rreth të xhiros totale të American Hospital, ka një normë fitimi bruto prej por që sipas shpjegimeve të vetë ndërmarrjes, mbi këto shërbime aplikohet zbritje e rregullt prej deri në ndërkohë që edhe kostot e financimit në raste huamarrje dhe interesat arrijnë në dhe nuk i transferohen pacientit. Për më tepër, drejtorëve të degëve të American Hospital, ju është lënë e drejta të aplikojnë ulje të mëtejshme nga për shërbimet kirurgjikale dhe radiologjike. Në konkluzion, marzhi mesatar i normës së fitimit neto referuar procedurave të trombektomisë është rreth
20. Duke vlerësuar pozicionin e ndërmarrjes në treg, ofrimin ekskluziv të disa shërbimeve thelbësore, përqindjen e lartë të pjesës së tregut, shtrirjen gjeografike dhe përfitimin nga financimi publik për shërbime që nuk ofrohen nga ofrues të tjerë, rezulton se American Hospital SHA ka ushtruar aktivitet në kushtet e një pozite dominuese në tregun përkatës të shërbimeve spitalore.

21. Megjithatë, nga analiza e sjelljes së ndërmarrjes nuk rezultojnë indicie të një sjelljeje abuzive me pozitën dominuese, në kuptimin e nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003. Çmimet për shërbimet e ofruara, përfshirë ato të mbuluara nga FSDKSH, janë transparente dhe të barabarta për pacientët, ndërkohë që ofrimi i këtyre shërbimeve ka ndodhur për shkak të mungesës së alternativave të tjera në sistemin publik.
22. Sipas deklarimeve zyrtare të ndërmarrjes International Hospital SHA, të protokolluara më datë 28.03.2025, kjo ndërmarrje ofron një sërë shërbimesh spitalore të cilësuar si eksportues të teknologjisë së lartë dhe të pamundura për t'u ofruar nga sektori publik. Në mënyrë të veçantë, spitali ofron: PET-scanner (PET-CT) – një procedurë diagnostikuese e avancuar me përdorim të kufizuar në rajon, transplantin e veshkave dhe paketat e radioterapisë, në disa variante teknologjiksht të diferencuara, përfshirë IMRT (Intensity-Modulated Radiation Therapy). Sipas verifikimeve të Autoritetit të Konkurrencës, këto shërbime nuk ofrohen nga Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe as nga institucione të tjera publike.
23. Të dhënat e siguruara nga ndërmarrja International Hospital SHA tregojnë një pjesëmarrje në treg në periudhën objekt hetimi me _____ të tregut për vitin 2022 dhe _____ të tregut për vitin 2023.
24. Bazuar në informacionet e administruara, për periudhën objekt hetimi ndërmarrja International Hospital SHA ka realizuar të ardhurat dhe normat e fitimit si më poshtë: Transplant normal i veshkës/renal (15 ditë) = _____ lekë Transplant Renal (me financim nga FSDKSH) = _____ lekë (), PET-scanner (PET-CT) = _____ Radioterapi Paketa 1 IH = _____ lekë (), Radioterapi Paketa 2 IH = _____ , Radioterapi Paketa 3 IH = _____ lekë (), Radioterapi Paketa 4 IH = _____ , Radioterapi Paketa 5 IMRT IH = _____
25. Këto të dhëna tregojnë se ndërmarrja International Hospital SHA ka norma fitimi të ulëta nga ofrimi i shërbimeve të teknologjisë së lartë (si PET-CT dhe IMRT), ndërkohë që shërbimet e mbuluara nga FSDKSH kanë rezultuar më pak fitimprurëse, duke sugjeruar se nuk ka pasur sjellje çmimesh të pajustificuara ose të padrejta ndaj institucionit publik. Në analizën e sjelljes së ndërmarrjes, duke u bazuar në kriteret e nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003, nuk identifikohen elementë që përbëjnë sjellje të abuzimit me pozitën dominuese.
26. Nga të dhënat e depozituara nga ndërmarrjet, rezulton se metodologjia e përcaktimit të çmimeve mbështetet në një strukturë të orientuar drejt kostos reale, duke përfshirë elementë të verifikueshëm si shpenzimet e stafit, pajisjet mjekësore të specializuara, materialet e konsumit, mirëmbajtjen, amortizimin dhe kostot e financimit. Shërbime të tilla si radioterapia, PET-CT apo transplantet e veshkave përfshijnë investime kapitale shumë të larta, si dhe kosto operacionale të ndjeshme që kërkojnë një marzh fitimi të arsyeshëm për garantimin e qëndrueshmërisë.
27. Për pjesën më të madhe të shërbimeve në fjalë, sidomos ato që nuk kanë natyrë urgjente, tregu përkatës është i natyrës rajonale, ku pacientët kanë zgjedhje reale dhe konkurrentë të drejtpërdrejtë operojnë në vende si Turqia, Maqedonia e Veriut apo Kosova. Kjo zhduk çdo mundësi reale për sjellje të njëanshme apo të pavarur nga presionet e tregut, që përndryshe do të ishin tregues të keqpërdorimit të pozitës dominuese.

28. Gjithashtu, sjellja e ndërmarrjeve nën hetim nuk përmbush asnjë nga format e tjera të abuzimit të parashikuara në nenin 9 të ligjit nr. 9121/2003. Përkundrazi, ofrimi i zbritjeve për pacientët e pasiguruar, fleksibiliteti i çmimeve për kategoritë më vulnerabël dhe bashkëpunimi me Fondet publike shqiptare dhe kosovare, reflektojnë sjellje që përputhen me standardet e përgjegjshmërisë sociale dhe konkurrencës së ndershme.
29. Në vlerësimin e situatës strukturore të tregut, nuk u evidentuan barrierat të konsiderueshme ligjore apo financiare për hyrjen në treg. Ndërmarrje të tjera të shërbimeve shëndetësore mund të operojnë në treg me licencim të rregullt, duke garantuar ekzistencën e një presioni konkurrues të mjaftueshëm.
30. Nga analiza e sjelljes së ndërmarrjeve American Hospital SHA dhe International Hospital SHA në tregun e shërbimit spitalor, nuk rezultojnë prova të mjaftueshme që të mbështesin konstatimin e një shkeljeje të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003, pasi mungojnë elementët thelbësorë lidhur me shkeljen e pretenduar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d), nenin 26 nenin 43, pika 5 dhe nenin 45, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjeve American Hospital SHA dhe International Hospital SHA në tregun e shërbimit spitalor.
- II. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjeve American Hospital SHA dhe International Hospital SHA për një periudhë 1 vjeçare.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Leida MATJA
()
Zv/Kryetar

Rezana KONOMI
()
Anëtar

Fatjola DELIJA
() *kunder*
Anëtar

Denar BIBA
()
Kryetar

